

STATUTI

Shoqerise tregetare me perjegjesi te kufizuar "Kola Invest & AGBES Construction" shpk

Ne Fier sot me date 27 / 07/ 2020/ ne seline e shoqerise "Kola Invest" shpk Fier ne mbeshtetje te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerit tregtare" dhe dispozitave perkatese te kontrates per krijimin e Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar " Kola Invest & AGBES Construction" shpk u mblohdhen palet e poshteshenuara :

1. "Kola Invest" shpk e perfaqesuar nga :

- Jani Kola i biri i Naunit lindur me 25.09.1959 ne Jagodine dhe banues ne Tirane Rruga "Ismail Qemali", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID F 90925023 U
- Sofokli Kola i biri i Spiros lindur 28.05.1966 ne Fier dhe banues ne Tirane Rruga "Ali Visha", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID G 60528024 G

2. "AGBES Construction" shpk e perfaqesuar nga :

- Arben Goga i biri i Pandit lindur me 23.11.1958 ne Fier dhe banues ne Tirane Rruga "Bilal Sina", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID G 81123041 J
- Bashkim Ramaj i biri i Lamces 02.01.1965 ne Fier dhe banues ne Tirane Rruga "Bilal Sina", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID G 50101222 P

te cilet rane dakord per hartimin e statutit te shoqerise se tregetare "Kola Invest & AGBES Construction" shpk si me poshte :

I. DEPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 1

Shoqeria Tregtare Private me kete statut ne perputhje me kontraten per krijimin e Shoqerise Tregtare Private me Pergjegjesi te Kufizuar "Kola Invest & AGBES Construction" shpk dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te e perfaqesuar nga ortakeve dhe te punonjesve te shoqersie, te dhenat me perjegjesi, per qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarise ekonomike te shoqerise dhe ceshtjeve te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

NENI 2

Shoqeria eshte krijuar me kontraten per krijimin e Shoqerise Tregtare Private "Kola Invest & AGBES Construction" shpk me mjetet financiare vetjake te ortakeve.

NENI 3

Shoqeria "Kola Invest & AGBES Construction" shpk ka statusin e personit juridik

NENI 4

Selia e Shoqerise Tregtare "Kola Invest & AGBES Construction" shpk eshte ne adresen Rruga Nacionale Fier – Tirane km-1 Lagjia "Sheq i madh Fier,

Konforme legjislacionit shqiptar ne fushen e veprimtarise ekonomike private dhe ne perputhje me planet dhe objektivat e veta ekonomike shoqeria mund te hap filiale ose zyra perfaqesimi te saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte territorit te shqiperise

NENI 5

Shoqeria e emertuar ne nenin 1 te ketij statuti , do te ushtroje veprimtarine e saj ekonomike me emertimin shoqeria "Kola Invest & AGBES Construction" shpk. Shoqeria do te kete vulen e vete.

II . OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 6

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "Kola Invest & AGBES Construction" shpk eshte.

- Ne fushen e menaxhimit , bashkerendimit dhe permbushjes se kontrates "Per punimet e ndertimit te vilave te Nuklit 24 perfshire strukturat inxhinierike dhe ato rrugore, parkimet dhe punimet e parcelizimeve dhe sistemimit te parcelave me konceptin punime te perfunduara me celsa ne dore sipas preventivit, projektit, detajeve, vizatimeve, dhe specifikimeve teknike ne Kompleksin Green Coast Resort Palse"
- Ne fushen e bashkerendimit te planeve , veprimtarive dhe aktiviteteteve te tjera te nevojshme me punedhenesin per permbushjen e kontrates se siperituar
- Ne fushen e menaxhimit, te administrimit dhe te shitjes te produktit te perfituar nga realizimi i ketij projekti
- Si dhe cdo aktivitet tjeter, qe vecmas ose se bashku me ato te përmendura me siper, do te konsiderohen te pershtatshme per permbushjen e kontrates se siperituar nga shoqeria.

NENI 7

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj te percaktuar ne kete statut ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj

NENI 8


Veprimtaria e shoqerise, emertimi dhe selia e saj nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e ortakeve. Ortaket mund te vendosin te krijojne filiale ose seli te tjera ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj ne perputhje me strategjine e zhvillimit te miratuar nga Asambleja e Ortakeve.

NENI 9

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimin e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit ne pajtim te plote me dispozitat llojore ne fuqi.

NENI 10

Per detyrimet e veta shoqeria per gjigjet me tere pasurine e saj. Shoqeria nuk per gjigjet per detyrimet qe ka secili ortak ndaj personave te trete



III. MJETET E SHOQERISE

NENI 11

Mjetet ne te holla dhe mjetet e tjera ne natyre per krijimin dhe fillimin e punes se shoqerise, ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise, i sigurojne ortaket ne shumen e per gjitheshme prej 100 000 (njeqinde mijë) leke, shume e cila perben dhe kapitalin themeltar te shoqerise Pjeset e kapitalit zoterojen ne masen

- Kola Invest shpk zoteron 50 % te kapitalit themelues
- AGBES Construction shpk zoteron 50 % te kapitalit themelues

Kapitali ndahet ne dy pjesa sipas kontributit te ortakeve me nje kuote sejcili

NENI 12

Pas celjes se llogarise xhiruese te shoqerise ne nje nga bankat e nivelit te dyte ortaket jane te detyruar qe mjetet financiare te pershkruara ne nenin 11 te ketij statuti t'i kalojne menjehere ne xhiro Ilogari.

NENI 13

Ortaket mbajne te drejten e pronesise mbi mjetet monetare te kapitalit themelues (kuotat) te percaktuara ne nenin 11 te ketij statuti dhe te investuara per krijimin e shoqerise per aq kohe sa nuk ja kane shitur kuotat e tyre ortakeve te tjere ose personave te trete.

NENI 14

Ortaket nuk perjigjen me pasurine e tyre vetiake per detyrimet e shoqerise.

NENI 15

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj te percaktuar ne kete statut ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise, me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj.

NENI 16

Shoqeria e kryen veprimtarine e vet me mjetet e investuara ne fondet e saj, me kredite e akorduara dhe me mjete te tjera. Shoqeria eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi nga shuma e mjeteve te investuara ne fondin themeltar te shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves.

NENI 17

Shoqeria percakton fondet e me poshteme.

- a. Fondin themeltar
- b. Fondin e mjeteve te xhiros
- c. Fondin rezerve

Per ushtrimin e veprimtarise se vet, shoqeria mund te percaktoje dhe fonde te tjera te perftuara nga fitimi neto i shoqerise, kredit ose hua te tjera te marra nga institucionet huadhenese.

NENI 18

Fondi themeltar i shoqerise formohet nga mjetet e investuara vetem prej ortakeve. Per mjetet e investuara ne fondin themeltar, ortakeve u leshohen letrat perkatese me vlere, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, neqoftese kjo e drejte ju jepet nga ligji.

NENI 19

Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se saj, per investime ne fondet e ndermarrjeve dhe organizatave te tjera qe i ka formuar ajo si dhe per te mbuluar rreziqet pas shfrytezimit te mjeteve te rezerves. Fondin themeltar, shoqeria mund ta shfrytezoje dhe per destinacione te tjera ne perputhje me aktet e politikes se saj ekonomike.

NENI 20

Fondi i mjeteve te xhiros dhe fondi rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit qe shoqeria e realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Asamblese se Ortakeve. Fondi i mjeteve te xhiros dhe fondi rezerve jane fonde vetiake te shoqerise. Fondi i mjeteve te xhiros sherben per te perballuar shpenzimet e zgjerimit te aktivitetit per lende te pare, energji dhe lende ndihmese. Mjetet e fondit rezerve shfrytezohen per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

NENI 21

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit finanziar vjetor nga Asambleja e Ortakeve, pjesa e fitimit neto ndahet midis ortakeve ose riinvestohet me miratimin e Asamblese se Ortakeve.

IV. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 22

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve si themeluese e shoqerise
- Administratori i shoqerise

• ASAMBLEJA E ORTAKEVE

NENI 23

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise.

NENI 24

Asambleja e Ortakeve perbehet ortaket e te dy shoqerive themeluese, qe jane ortaket themelues. Neqoftese numeri i ortakeve mund te rritet mbi 3 ortake atehere Asambleja e Ortakeve zgjidhet midis ortakeve me sistem rotaconi kur kontributet e tyre jane te barabarta ose midis tre ortakeve qe disponojne 51 % te kapitalit ne momentin e zgjedhjeve. Asambleja e Ortakeve zgjidhet ne mbledhjen e per gjitheshme te asamblese.

NENI 25

Asambleja e Ortakeve do te beje mbledhjen e pare jo me vone se 10 dite nga data e regjistrimit te shoqersie ne Regjistrin Tregetar qe eshte e njejt aite me diten e shpalljes se vendimit te te Qendres Kombetare te Biznesit Tirane per regjistrimin e shoqerise

NENI 26

Asambleja e ortakeve ka keto detyra:

- Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit dhe akte te per gjitheshme, vendimin per ndryshimin e emertimit te selise dhe veprimtarise se shoqerise.
- Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitali themeltar te shoqerise.
- Jep udhezime te nevojshme dhe orienton punen e administratorit te shoqerise.
- Miraton bilancin vjetor dhe raportin finanziar vjetor te shoqerise
- Vendos per ndarjen dhe per dorimin e fitimit dhe per mbulimin e humbjeve dhe te rreziqeve.
- Vendos per ndryshimin e forms se organizimit te shoqerise.
- Nxjerr rregulloren per punen e asamblese se ortakeve
- Drejton punet e tjera te rendesishme per afarizmin e shoqerise.

NENI 27

Asambleja e ortakeve punon dhe vendos vetem ne mbledhje. Te gjitha diskutimet dhe vendimet qe merren protokollohen dhe ne fund te cdo mbledhje firmosen nga gjithe Asambleja e Ortakeve. Cdo vendim i marre ne kundershtim me nenin 27 eshte i pavlefshem.

NENI 28

Asambleja e ortakeve vendos me shumice votash, por per ceshtjet e poshteshenuara eshte i detyrueshem unanimiteti ne votim

- Miratimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave financiare
- Mandatimin e administratorit te deleguar
- Miratimi Strategjive te zhvillimit
- Emerimi likujdatorit
- Vendimi per shperberjen e shoqerise para afatit

Ne raste te mosarritjes se unanimitetit shoqeria automatikisht kalon ne proces likujdimi

• ADMINISTRATORI I SHOQERISE

NENI 29

Shoqeria ka administratorin e vet

Administratore te Shoqerise Private me Pergjegjesi te Kufizuar "Kola Invest & AGBES Construction" shpk jane z. Jani Kola, dhe z. Arben Goga.

NENI 30

Mandati i administratoreve te shoqersie jepet per nje periudhe 3 vjecare, aq sa eshte dhe afati i veprimtarise se shoqerise. Jo me vone se 15 dite para perfundimit te mandatit tre vjecar Asambleja e Ortakeve vendos per zgjatjen e ose jo te afatit te veprimtarise dhe nese vendos per zgjatjen e afatit vvendos njekohesisht per zgjedhjen e administratorit te ri. Ne praktike te gjitha funksionet e administratorit me miratimin e Asamblese se Ortakeve mund ti delegohen nje punonjesi te emeruar ose njerit prej administratoreve te percaktuar ne nenin 29 i cili vendos vecmas dhe solidarisht me administratorin tjeter dhe eshte perqejges para Asamblese se Ortakeve per rezultatet financiare te shoqerise. Mandati administratorit te deleguar eshte njevjecar. Dhenia e mandatit Administratorit te Deleguar behet cdo vite ne mbledhjen e pare te Asamblese se Ortakeve por jo me vone se data 10 Janar e vitit ne vazhdim.



NENI 31

Ne mungese apo pamundesi te ushtrimit te funksionit nga Administratori i Deleguar ose per shkaqe te ndryshme per nje periudhe te caktuar kohe nuk eshte mandatuar Administratori i Deleguar atehere per kete periudhe te dy administratoret jane solidarisht administrator te shoqerise.

NENI 32

Administratori i shoqersie ka keto detyra

- Organizon dhe drejton punen e shoqerise.
- Perfaqeson, shoqerine para institucioneve shteterore dhe personave te tjere
- Pergjigjet per ligjeshmerine e puneve si dhe per aktivitetin ekonomik te shoqerise.
- Propozon nxjerrjen e akteve nga kompetencat e e Asamblese se Ortakeve te percaktuara nga neni 26 i ketij statute.
- Propozon organizimin e shoqerise, percakton numin dhe strukturen e kualifikimit te punonjesve.
- Lidhe kontrata dhe kryen pune e veprime te tjera juridike brenda autorizimeve te Asamblese se Ortakeve.



- Administratori i shoqerise nuk ka te drejte te shese apo te tjetersojse asetet dhe mjetet themelore te shoqerise te listuara ne bilancin ekonomiko financiar te shoqerise pa miratimin e Asamblese se Ortakeve.
- Kryen te gjitha punet ne shoperi, te cilat sipas ketij statuti nuk jane ne kompetence te Asamblese se Ortakeve.

NENI 33

Administratorit te deleguar te shoqersie mund ti nderpritet mandati.

- Me kerkesen te tij.
- Kur ortaket bashkerisht ose sejcili prej tyre vertetojne se administratori eshte perjegjes per mosarritjen e rezultateve te shoqerise.
- Ne raste te tjera te parashikuara me ligj.

V. MENYRA DHE KUSHTET E NDARJES SE FITIMIT

NENI 34

Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve per lende te para, energji, paga dhe shpenzimeve te tjera te njohura nga ligji "Per Kontabilitetin", nga fitimi i shoqersie pas ndarjes se mjeteve per pagesen e tatimit mbi fitimin, shoqerise i ,mbetet ne dispozicion fitimi neto i cili ne perputhje me nenin 1 1 te ketij statuu ndahet.

- Kola Invest shpk 1/2 pjese e fitimit neto
- AGBES Construction shpk 1/2 pjese e fitimit neto

Secili ortak mund te perdore lirisht, sipas deshires se tij, pjesen e vet te fitimit

NENI 35

Ortaket bartin rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve (kuotes) te investuara me rastin e krijimit te shoqerise.

NENI 36

Neqoftese ortaket i kane mbuluar njehere humbjet e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve (kuotes) te investuara me rastin e krijimit te saj, nuk jane te detyruar te bartin rrezikun per humbje te metejshme.

NENI 37

Neqoftese ne bilancin vjetor shoqeria nuk del me fitim por me humbje, humbjet do te mbulohen ne perputhje me nenin 35 te ketij statuti. Neqoftese shoqeria per tre vite ushtrimorte te njepasnjeshme rezulton me humble atehere shoqeria me propozimin e nje prej ortakeve dhe miratimin e Asamblese se Ortakeve mund te pushoje aktivitetin ekonomik dhe te shkoj drejte likuidimit

NENI 38

Fitimi i shoqerise me rastin e paraqitjes se rrrethanave nga neni 35 i ketij statuti, nuk do te ndahet ne perputhje me nenin 34 te ketij statuti por do te mbulohen se pari humbjet e rezultuara ne bilancin e viti parandhes.

NENI 39

Neqoftese humbjet e shoqerise nuk do te mbulohen , mjetet e ortakeve themelues, te dhena me rastin e krijimit te shoqerise, ne perputhje me nenin 35 te ketij statuti, ndaj shoqerise hapet procedura e likuidimit, perkatesisht e falimentos.

VI. MARREDHENIET E PUNES

NENI 40

Maredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise, kodin e punes dhe legjislacion shqiptar te punes si dhe me kete statut

NENI 41

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje

- Kushtet dhe menyra e lidhjes se maredhenies se punes.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendet e punes.
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale te punes, puna ne ditet e pushimit favor dhe te festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes
- Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe perjegjesit e punonjesve per caktimin e detyrave te punes.
- Pushimi i maredhenieve te punes midis punedhenesit dhe punemarresit

NENI 42

Punonjesit per punen e tyre, marrin pagen, ne vartesi te rezultateve, te arritura ne pune, ne perputhje me kontraten e punes. Ne kontraten e punes caktohet paga e punes se punonjesit, orari i punes, shperblimi i pages dhe shperblime te tjera.

NENI 43

Punonjesi eshte personalisht perjegjes per kryerjen e puneve dhe zbatimin me korrektese te disiplines ne pune, te disiplines teknike dhe teknologjike, te zbatimit te rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune.

VII. KOHEZGJATJA E SHOQERISE DHE MBYLLJA

NENI 44

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet per nje periudhe te paracaktuar 3 vjecare sa eshte dhe afati I kontrates per realizimin e te ciles krijohet kjo shoqeri

NENI 45

Shoqeria mbyll aktiviteti e saj:

- Ne rastet e percatuara ne legjislacionin shqiptar.
- Ne baze te vendimit te Asamblese se Ortakeve
- Kur te hapet procedura e likuidimit, perkatesisht e falirnentimit.

NENI 46

Ne rastet e likuidimit te shoqerise , ortaket marrin pjese ne ndarjen e pasurise dhe shoqersie, ne perpjestim dhe me pjesmarrjen e tyre ne pasurine e shoqerise ne momentin e likujdimit

NENI 47

Ne se procedura e likidimit te shoqerise perfundon me humbje , ortaket mbulojne humbjet nga kuotat themeluese te dhena me rastin e krijimit te shoqerise, ne perputhje me nenin, 39 te ketij statuti.

NENI 48

Ne se ndonje humbje e meparshme e shoqerise eshte mbuluar ne perputhje me nenin 39 te ketij statuti, do te hapet procedura e falimentimit te shoqerise.

VIII. DEPOZITA E FUNDIT

NENI 49

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregetar nga Qendra Kombetare te Biznesit Tirane.

NENI 50

Ndryshimet e ketij statuti behen ne te njejtmen menyre dhe procedure me te cilen nxirret ky statut. Propozmi per ndryshim dhe plotesimin e statutit mund te jape sejciili prej ortakeve te shoqerise. Per te votuar ndryshimet ne statut eshte i detyrueshem unanimiteti i Asamblese se Ortakeve

NENI 51

Mosmarreveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizik vendas a te huaj zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten kur ajo nuk arrihet, zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

NENI 52

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet Ligji "per Shoqerit Tregetare" Kodit Tregtar te Republike Shqiperise, Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe cdo akt tjeter ligjor te legjislacionit.

NENI 53

Statuti perpilohet ne kater kopje per t'u dorezuar organeve kompetente. Dy kopje te statutit mbeten si pjese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise Tregtare Private "Kola Invest & AGBES Construction" shpk

Te dy ortaket pasi e lexuan statutin dhe nuk paten asnje kundershtim e firmosen ate pa rezerva.

ORTAKET THEMELUES

Kola Invest shpk

Sofokli Kola

Jani Kola



AGBES Construction shpk

Bashkim Ramaj

Arben Goga



KONTRATA


E SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KOLA INVEST & AGBES CONSTRUCTION" SHPK.

Ne Fier sot me datën 27/07/2020, ne mbështetje te Ligjit Nr.9901 date 14 prill 2008 "Për Shoqëritë Tregëtare", ne seline e shoqerise "Kola Invest" shpk u mblohen palet e poshteshenuara :

1. **"Kola Invest" shpk** një shoqeri e organizuar konforme legjislacionit ne Republiken e Shqiperise me NIUS (NIPT-in) K93103401G me seli ne adresen Lagja "Kryengritja e Fierit" Rruga "Aulona" e perfaqesuar nga :
 - Jani Kola i biri i Naunit lindur me 25.09.1959 ne Fier dhe banues ne Tirane Rruga "Ismail Qemalili", madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID F 90925023 U
 - Sofokli Kola i biri i Spiros lindur 28.05.1966 ne Fier dhe banues ne Tirane Rruga "Ali Visha", madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID G 60528024 G
2. **"AGBES Construction" shpk** një shoqeri e organizuar konforme legjislacionit ne Republiken e Shqiperise me NIUS (NIPT-in) K93103401G me seli ne adresen Lagja "Sheq i Madh" Rruga "Rruga Nacionale Fier-Tirane km 1" e perfaqesuar nga :
 - Arben Goga i biri i Pandit lindur me 23.11.1958 ne Fier dhe banues ne Tirane Rruga "Bilal Sina", madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID G 81123041 J
 - Bashkim Ramaj i biri i Lamces 02.01.1965 ne Fier dhe banues ne Tirane Rruga "Bilal Sina", madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar mbajtes i Kartes se Identitetit me ID G 50101222 P

te cilet me vullnetin e tyre te lire e te plete vendosën te ushtrojnë veprimtarinë e tyre private, duke themeluar Shoqërine Tregëtare me Përgjegjësi te Kufizuar "Kola Invest & AGBES Construction" shpk me qëndër ne qytetin e Fierit.

1. Ne kuptim te kësaj kontrate palet janë themeluesit e Shoqërisë Tregëtare "Kola Invest & AGBES Construction" Shpk.
2. Kapitali themelues i shoqerise eshte 100,000 (njeqinde mijë) leke. Pjesemarrja e e sejcilit ortake ne kapitalin themelues te shoqerise eshte si me poshte :
 - Kola Invest shpk 50%
 - AGBES Construction shpk 50 %



3. Te drejtat dhe detyrat e ortakëve themelues janë përcaktuar hollësishët në statutin e shoqërisë .
4. Objekti i shoqërisë tregtare "Kola Invest & AGBES Construction" shpk është
 - Ne fushen e menaxhimit , bashkerendimit dhe permbushjes se kontrates "Per punimet e ndertimit te vilave te Nuklit 24 perfshire strukturat inxhinierike dhe ato rrugore, parkimet dhe punimet e parcelizimeve dhe sistemimit te parcelave me konceptin punime te perfunduara me celsa ne dore sipas preventivit, projektit, detajeve, vizatimeve, dhe specifikimeve teknike ne Kompleksin Green Coast Resort Palse"
 - Ne fushen e bashkerendimit te planeve , veprimtarive dhe aktivitetet e tjera te nevojshme me punedhenesin per permbushjen e kontrates se sipercituar
 - Ne fushen e menaxhimit, te administrimit dhe te shitjes te produktit te perfituar nga realizimi i ketij projekti
Si dhe cdo aktivitet tjeter, qe vecmas ose se bashku me ato te përmendura me siper, do te konsiderohen te pershtatshme per permbushjen e kontrates se sipercituar nga shoqeria.
5. Kontrata do te jetë efektive nga dita e regjistrimit te saj dhe statutit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Nga kjo ditë shoqëria fiton zotësinë per te vepruar si person juridik i pavarur.
6. Marrëveshja midis palëve lidhet me një afat te pecaktuar 3 vjecar aq sa eshte percaktuar dhe afati i perfundimit te kontrates se objektit
7. Palët e kësaj kontrate janë te detyruara të zbatojnë statutin e shoqërisë dhe mbajnë përgjegjësi per thyerjet disiplinore ose dëmtimin e pasurisë se saj.
Asambleja e Ortakëve dhe administratoret mund te marrin masa ndëshkimore ndaj atyre që nuk punojnë ne shoqëri ne perputhje me statutin e shoqërisë.
8. Palët e kesaj kontrate dhe te gjithë punojesit janë te detyruar te ruajnë karakterin e fshehte te dokumentacionit, njojurive dhe pervojës se shkëmbyer ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
9. Palët janë të detyruara të ruajnë të fshehtë identitetin e shumave dhe të ardhurave te shoqërisë depozitimeve të saj dhe aktivitetin e shoqerisë tregtare qe pasqyrojnë ne bilancin vjetor.
10. Kapitali fillestar i themelimit të shoqërisë perbëhet nga kontributi fillestar i palëve te caktuara ne statutin e shoqërisë. Kapitali fillestar baze është i mjaftueshëm per fillimin e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të shoqërisë.
11. Kapitali i themelimit te shoqërisë dhe kapitali i mëvonshëm mund te krijojë një fond te vecante që do të mbahet ne llogarine e shoqerise. Te dy ortaket vec e vec dhe solidarisht jane përgjegjese per permbushjen e kontrates.
12. Fondet monetare te shoqërisë do të perdoren nga Asambleja e Ortakëve dhe administratori i saj ne përputhje me detyrat e caktuara ne statutin e shoqerisë, në lidhje me objektin e veprimtarisë se shoqerise dhe shtrirjen e saj nga koha ne kohe.




- 13.** Palët themeluese kane te drejtë te celin llogari likuiduese me vehte ne bankë. Gjithashtu kane te drejte te nxjerrin bilance periodike per veprimtarinë ekonomike financiare dhe perfitojnë perqindjet e interesit, te cilat percaktohen dhe miratohen nga Asamblea e Ortakeve te shoqërisë.
- 14.** Shoqëria "Kola Invest & AGBES Construction" shpk duke qene person juridik i pavarur rregullon veprimtarinë e saj ne përputhje me dispozitat e kesaj kontrate themeluese, te statutit dhe legjisacionit në fuqi ne Republikën e Shqiperise.
- 15.** Te gjitha mosmarrëveshjet zgjidhen nga Asamblea e Ortakëve te shoqërisë dhe kur nuk është e mundur nga Gjykata e Rrethit Tiranë.
- 16.** Shoqëria "Kola Invest & AGBES Construction" shpk e ka qendrën e saj ne qytetin e Fierit. Ajo mund te zhvillojë veprimtarinë e saj ne te gjithe territorin e Republikës se Shqipërisë
- 17.** Palët themeluese dhe c'do punonjës i shoqerise tregtare te njihet me dokumentacionin baze te shoqërisë, te përbere nga kjo kontrate dhe statuti i saj.

Kjo kontrate pasi u redaktua j'u lexua te interesuareve te cilet e degjuan, e miratuan dhe e nenshkruan ate pa rezerva.


THEMELUESIT

KOLA INVEST SHPK

Z. JANI KOLA



Z. SOFOKLI KOLA






REPUBLICA E SHQIPERISE
SHOQERIA E NDERITIMIT
KOLA INVEST
sh.p.k.
FIER

AGBES CONSTRUCTION SHPK

Z. ARBEN GOGA



AGBES CONSTRUCTION sh.p.k.
FIER
REG. NO. 007432W

Z. BASHKIM RAMAJ